



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2020:129643

Datë: 01.02.2021

Numri i dokumentit: 01460493

**C.nr.1051/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike te paditëses: S.S nga Mitrovica te cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. O.H nga Mitrovica, kundër te paditurës: S... me seli ne Mitrovicë, për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te 2 pagave te shpërblimit jubilar me vlerë 825.64€, pas mbajtjes se seancës te dt.28.01.2021, me dt.01.02.2021 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**OBLIGOHET** e paditura S... ne Mitrovicë t'ia paguajë paditëses S.S nga Mitrovica, në emër te pagesës te dy pagave për shpërblim jubilar për periudhën e punës mbi 20 vite, shumën totale prej **825.64€ (Tetëqind e njëzet e pesë euro e gjashtëdhjetë e katër cent)**, të gjitha ne afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit te aktgjykimit, nen kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**OBLIGOHET** i paditura S... ne Mitrovicë t'ia paguajnë paditëses S.S nga Mitrovica, shpenzimet e procedurës në shumë totale prej **259 euro (dyqindë e pesëdhjetë e nëntë euro)**, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes te autorizuarit te saj Av. O.H me datën 07.10.2020 ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale ne emër te shpërblimit jubilar ne shumen prej 917.16 € për dy paga duke u bazuar ne Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive te Kosovës te dt.18.03.2014 si dhe ne nenin 17 par 3 nën par.3.2 te Kontratën Kolektive Sektoriale te miratuar 11.06.2018.

Gjykata, me datë 28.01.2021, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses, dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditëses në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se parimisht mbetem pranë padisë dhe kërkesëpadisë me te cilën paditësja ka kërkuar pagesat jubilarë, ne referatin e padisë janë lëshuar disa gabime teknike ashtu qe ne i kërkojmë vetëm dy paga ne emër te shpërblimit jubilarë pasi qe paditësja ka vetëm 20 vite përvojë pune ndërsa sa i përket bazës ligjore ne gabimisht e kemi përmendur marrëveshjen e përgjithshme kolektive pasi qe është përmendur edhe kontrata sektoriale prandaj tani beje përmirësimin sa i përket bazës ligjore ne

kërkojmë që këto pagesa të paguhen në konformitet me Kontratën Kolektive Sektoriale të parapara me këtë kontratë e cila mban datën 11.06.2018, dhe ka përcaktuar se në nenin 17 para 3 nën para 3.2 ku është parapara që për 20 vite përvojë pune punëtorit i takojnë 2 paga në emër të shpërblimit jubilar, prandaj ne e bëjmë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që për dy paga në emër të shpërblimit jubilar kërkojmë shumën 825.64 euro pasi që paga mesatare që paditësja realizon është 412.82 euro krejt kjo duke u bazuar në listën e pagës të muajit Dhjetor 2020 mirëpo në këtë listë edhe pse janë disa shtesa të tjera siq janë shujtat dhe Covidi ne nuk i kemi përllogaritur të njëjtat, ndërsa sa i përket kamatës ligjore heq dore, ndërsa shpenzimet e procedurës i kërkojmë dhe atë për përpilim të padisë 104 euro, për përfaqësim në një seancë 135 euro si dhe për takse gjyqësore 20 euro.

Përfaqësuesja e të paditurës në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi Nuk e kontestoj bazën juridike të padisë së përmirësuar dhe të precizuar në këtë seancë, menaxhmenti i spitalit e ka refuzuar kërkesën e paditëses në mungesë të mjeteve financiare të planifikuara për paga jubilarë, ashtu siq qëndron edhe në vërtetimin e lëshuar nga ana e menaxhmentit. Nuk e kontestoj lartësinë e pagës e as përvojën e punës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kontrata e punës e dt.28.12.2012, Vendimi i lëshuar nga e paditura dt.17.06.2020, Vërtetimi lëshuar nga e paditura dt.21.02.2020, Kopja e letërnjoftimit për paditësen si dhe Lista e pagës për muajin Dhjetor 2020, dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Për gjykatën nuk është kontestuese se paditësja i ka 20 vite përvojë pune në institucionet shëndetësore, kjo vërtetohet nga vërtetimi lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm "Dr.Sami Haxhibeqiri" datës 21.02.2020, si dhe nga lista e pagës për muajin Dhjetor 2020 po ashtu provoja e punës nuk është kontestuar as nga e paditura..

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës bazë që paditësja ka realizuar nga e paditura është shuma mujore prej 412.82€ ku kjo vërtetohet nga lista e pagës e muajit Dhjetor 2020, ku shihet qarte se paga ka qene ajo që përmendet me larte.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarës të të paditurës duke e kontestuar padinë si pasojë e mjeteve buxhetore, pretendim e lartcekur gjykata e refuzoj si të pa bazuar, dhe atë duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të miratuar në dt.11.06.2018, andaj për vendosje sipas pikës I të dispozitivit sa i përket pagesës së dy pagave në emër të shpërblimit jubilar Gjkata iu referua nenit 17 par 3 nën par.2 të Kontratës së lartcekur me të cilën parashihet se "Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij", e në rastin konkret paditësi është i punësuar të e paditura mbi 20 vite, dhe vazhdon me tutje.

Bazuar në nenin 17 par.4 Kontratën Kolektive Sektoriale është detyrim i punëdhënësit të fundit që paditësit të paguaj kompensimin për kategorinë e lartcekur.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve në shumën prej 104 euro për përpilim të padisë, për përfaqësim në seancë dhe 135 euro dhe në emër të taksës për padi 20 euro.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 te LPK-se.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.1051/2020, datë 01.02.2021**

**GJYQTARI**  
Naim Mehulli

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtine. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.